



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MSH-së	
Nga:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MPL	Datë: 16.06.2020
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	Nr.43-339/24
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glogocit	
Lloji i aktit:	Rregullore e Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Rregulloren 12-400-16587 për ndryshim plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Shëndetësisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Departamenti Ligjor/Pravni Departament/Legal Department

Për:	Goran Rakiq-zëvendëskryeministër dhe ministër i Ministrisë së Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretar i Përgjithshëm, MAPL. Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave, MAPL
Kopje:	Kryetari i Komunës së Glllogocit
Përmes:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL. Z.Armend Zemaj, Ministër i Shëndetësisë Dr.Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm në MSH
Nga:	Aferdita Hoxha, U.D Udhëheqës i Departamentit Ligjor
Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Mirvete Kelmendi, Udhëheqëse e Divizionit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit, të mbështetjes ligjore dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e legjislacionit Data: 11.06.2020
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit
Lloji i Aktit:	Akti i Kuvendit të Komunës Glllogoc

E nderuara Ministre,
E nderuara Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Shëndetësisë ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje L.okale aktin komunal në vijim:

Rregulloren Nr.12-400-16587 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.

Dokumenta i miratuar me dt.27/05/2020.

I dërguar për shqyrtim në MSh, me datë: 05/06/2020

Ministria e Shëndetësisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtueshmëri me dispozitat e legjislacionit në fuqi me Ligjin për Shëndetësi Nr. 04/L 125, Udhëzimin Administrativ Nr.04/2013 për Certifikatat Shëndetësore.

Pajtueshmëri e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë është si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në pajtueshmëri.
1	Rregullorja Nr.12-400-16587 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.	Ligji për Shëndetësi nr. 04/L 125, neni 8 dhe 18 përcakton se politikat shëndetësore hartohen nga Ministria e Shëndetësisë përfshirë edhe kujdesin parësor shëndetësor. Ministria e Shëndetësisë si institucion përgjegjës në fushën e shëndetësisë ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit të Kuvendit të Komunës së Glogocit, Rregulloren Nr.12-400-16587 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba dhe ka konsideruar se është në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, Udhëzimin Administrativ për Certifikatat Shëndetësore Nr.04/2013. Ky udhëzim administrativ përcakton llojet e certifikatave shëndetësore, institucionet shëndetësore, komisionet mjekësore, punëtorët shëndetësor dhe kushtet për lëshimin e certifikatave shëndetësore. Të gjitha aktet e Komunave në fushën e shëndetësisë duhet të jenë në përputhje me politikat nacionale për KPSH.

Ministria e Shëndetësisë, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOQOC			
GLLOQOC MUNICIPALITY			
Pranuar	27. 05		2020
Nj. Org.	Numër	Rithjeka	Vlera
12 -	400 -	16587	



Republika e Kosovës
Komuna Drenas
Kuvendi Komunal



RREGULLORE PËR NDRYSHIM-PLOTËSIMIN
PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA

Maj, 2020

Bazuar në nenin 11,12 , dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-40, nenit 34, pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit,në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 shkronja C të ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040 („Gaz. Zyrt. e Republikës së Kosovës”), nenit 2 paragrafi 3 ,nenit 8,10,12,14,15,16.17,18,19 dhe 20 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-049 („Gaz. Zyrt. e Republikës Kosovës”),UA i MMPH nr. 14/2015 dhe UA i MMPH nr. 01/2017, Neni 15 paragrafi 1, nën paragrafi 1.8 i Ligjit për mbeturina nr. 04/L-060, neni 22 i Ligjit Nr. 04/L-110 për ndërtimin edhe Udhëzimi Administrativ nr. 02/2018 për Taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës, Neni 29 (paragrafi 4 dhe 5) të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, Rregullorja e MASHT nr. 1/2017,për planifikimin e shpenzimit të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional dhe aftësimit për të rriturit si dhe Udhëzimit 3/2013 për lëshimin e dokumenteve dublikate nga institucionet arsimore, UA nr. 04/2007,për mbledhjen dhe shfrytëzimin e bashkë pagesave të shfrytëzuesve të Shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të institucioneve shëndetësore dhe UA nr. 04/2013 për certifikata Shëndetësore, nenit 59 të Statutit të Komunës së Glogocit të aprovuar në vitin 2008, dhe shkresës nga MAPL nr. 43-468/1 e dt. 17.11.2017, Kuvendi i Komunës së Glogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.05.2020, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret për obliguesit ndaj shërbimeve komunale si: lartësia e pagesës, mënyra e ngarkesës - llogaritjes,mënyra e arkëtimit, afati i pagesës, mbikëqyrja inspektuese, evidentimi,taksat dhe gjobat,pastaj dispozitat ndëshkuese, si dhe ankesat në ngarkesat e parapara në vazhdim të kësaj Rregulloreje.

Neni 1

Bartës të obligimeve për shërbimet komunale janë personat fizikë dhe juridikë

- 1.1. Personat, të cilët paraqesin kërkesë për certifikata të ndryshme, vërtetime apo deklarata të cilat lëshohen nga Drejtoratet komunale.
- 1.2. Personat juridikë dhe fizikë, të cilët bëjnë procedimin e kërkesave të tyre për pëlqimin për Biznes.
- 1.3. Personat/Subjekte afariste dhe profesionalistët që kërkojnë marrjen e pëlqimit nga Drejtorati përkatës për Pëlqimin për punë në biznes dhe leje të tjera specifike.
- 1.4. Personat/Subjekte afariste që kërkojnë marrjen e lejes për mjetet motorike.
- 1.5. Personat të cilët bartin pronat përmes transaksioneve.
- 1.6. Personat të cilët janë shfrytëzues të përkohshëm të tokës dhe pronës me ndërtime dhe pa ndërtime.

- 1.7. Subjektet apo personat të cilët organizojnë manifestime sportive dhe kulturore
- 1.8. Subjekti fizik apo juridik për ndërtimin e ndërtesave individuale banesore, banesave kolektive dhe hapësirave afariste.
- 1.9. Subjektet apo personat tek të cilët kryhet inspektimi i përshkruar në tarifën përkatëse.
- 1.10. Subjektet, të cilët merren me shfrytëzimin e resurseve natyrore të parapara me tarifën përkatëse .
- 1.11 Subjektet apo personat, të cilët paraqiten pronarë, mbajtës të shtazëve dhe kafshëve të tjera përkëdhelëse.
- 1.12. Subjektet apo personat, të cilët kërkojnë nga Drejtorati për Kadastër Gjeodezi dhe e Pronë shërbime sipas tarifës së përcaktuar.
- 1.13. Subjektet apo personat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike për biznese dhe parkingje sipas tarifave përkatëse.
- 1.14 Subjektet apo personat juridik e fizik të cilët kanë pronë apo janë shfrytëzues të pronës e që janë të obliguar ta paguajnë Tatimin mbi pronën.
- 1.15 Subjektet apo personat juridik dhe fizik duhet ti nënshtrohen ligjit të komunikacionit dhe të cilët u përgjigjen edhe ndëshkimeve (gjobave)në trafik.
- 1.16. Subjektet apo personat, të cilët bëjnë ekspozimin publik të vitrinave reklamuese,apo panove reklamuese, si dhe organizimin e lojërave argëtuese të fatit dhe lojërave automatike, si dhe rekuizitave të tjera sportive sipas tarifave përkatëse.
- 1.17. Personat që paraqesin kërkesë për caktimin e kushteve urbanistike – teknike,
- 1.18. Personat që paraqesin kërkesë për leje ndërtimore,
- 1.19. Personat që paraqesin kërkesë për leje përdorimi.
- 1.20. Subjektet apo personat juridik dhe fizik për regjistrim apo ri-regjistrimin të automjeteve
- 1.21. Personat që paraqesin kërkesë për leje pune në afarizëm .

Neni 2

Lartësia e shumës për kërkesë për dhënien e certifikatës, deklaratës, vërtetimit, ushtrimin e veprimtarive në biznese, rentave, qerasë-shfrytëzimit të hapësirave komunale, lejeve ndërtimore, kompensimeve për inspektime, gjobave dhe pagesa të tjera, përcaktohen me tarifa përkatëse, të cilat janë pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Tarifat e subjekteve caktohen sipas kësaj Rregulloreje, dhe realizohen me aktvendime-kontrata-fatura të Drejtorateve sipas kërkesave të paraqitura.

Për ngarkesa të tjera obligimet llogariten dhe paguhën me rastin e dorëzimit të kërkesës nga ana e subjekteve të ndryshme.

Neni 4

4.1. Subjektet, tarifën e caktuar në bazë të kësaj rregulloreje , do ta paguajnë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të faturës(njoftimit).

Përfshihet nga alinea 1. e këtij neni, ngarkesat e caktuara për operimin e firmave dhe të tatimit në pronën e paluajtshme, të qytetarëve dhe të personave juridikë, do të paguhet në 2 këste të barabarta dhe atë:

- Për subjekte afariste dhe tatimpaguesit e tatimit në pronë;
- Kësti i parë deri më 30 prill,
- dhe kësti i dytë deri më 30 shtator .

Neni 5

Nëse obligimet e caktuara me vendim nuk paguhet brenda afatit të caktuar sipas nenit paraprak, ndëshkimet do të aplikohen në bazë të kësaj Rregulloreje.

Neni 6

Në rast të mos pagesës së taksës, Komuna do të veprojë sipas dispozitave ligjore, duke shfrytëzuar të drejtën e mbylljes së subjekteve afariste dhe dërgimin në përmbarrim për mbledhjen e borgjëve.

Neni 7

Drejtoritë përkatëse komunale për ngarkesat dhe pagesat sipas kësaj Rregulloreje, do të mbajnë evidenca në harmoni me dispozitat përkatëse ligjore.

Neni 8

Për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje, në kuadër të autorizimeve të veta kujdesen Drejtoratet përkatëse. Por nëse gjatë punës së tyre, Drejtoratet hasin në parregullsi, do të bëjnë përpjekje për t'i evituar ato dhe do të bëjnë propozime përkatëse për eliminimin e parregullsive. Këto punë, Drejtoratet do t'i kryejnë përmes personave zyrtarë.

Neni 9

Obliguesit duhet t'i paguajnë ngarkesat dhe taksat sipas Rregullores komunale në llogaritë përkatëse të Komunës, drejtpërdrejt në arkën komunale deri në 10 € ndërsa përmes bankave afariste në shumën mbi 10 € .

ANKESAT DHE MBROJTJA JURIDIKE

Neni 10

Personi mund të bëjë ankesë ndaj vendimit të lëshuar nga Komuna, nëse ai /ajo mendon se i janë shkelur të drejtat e tij. Procedura e ankesës duhet të jetë në pajtueshmëri me procedurën e referuar në nenin 85 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 .

Neni 11

Ndaj vendimit përfundimtar të Komunës mund të ushtrohet ankesë Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave nga Taksat Ngarkesat e Gjybat të Komunës së Drenasit.

1. – TAKSAT DHE NGARKESAT PËR LËSHIMIN E DOKUMENTEVE ZYRTARE

Neni 12

Përgjegjëse: Drejtoria e Administratës dhe organet tjera komunale, të cilat në procedurë administrative vendosin lidhur me parashtresat e subjekteve - parashtruesve të kërkesave për lëshimin e dokumenteve zyrtare, kopjeve të dokumenteve nga evidenca zyrtare, si dhe për shërbimet e përcaktuara në këtë tarifë.

Obligues: Parashtruesit e kërkesave.

Arkëtimi i pagesës : Me rastin e dorëzimit të kërkesës.

2. Tarifat për lëshimin e Certifikatave dhe dokumentacionit zyrtar

Dhënia e certifikatave nga shërbimi i ofiqarisë

1	Certifikata – Extrakt i lindjes	1 €
2	Certifikatë Martese	1 €
3	Certifikatë Vdekjes	1 €
4	Vërtetim nga arkivi	1 €
5	Certifikatë për gjendjen i/e lirë për martës	2 €
6	Certifikata e shtetësisë	1 €
7	Certifikatë për ç' lajmërimin e vendbanimit	1 €
8	Certifikatë mbi vendbanimin	1 €
9	Deklarata e bashkësisë familjare	1 €
10	Dëshmi vdekjeje (regjistrimi i trashëgimisë)	2 €
11	Ceremonia martesore në mes të personave vendor	5 €
12	Martesat kur njeri nga bashkëshortët është shtetas i huaj	10 €
13	Kurorëzimi brenda objektit të komunës, jashtë orarit të punës	20 €
14	Kurorëzimi jashtë objektit të komunës, brenda orarit të punës	25 €
15	Kurorëzimi jashtë objektit të komunës, jashtë orarit të punës	40 €
17	Aktvendimet për regjistrime të mëvonshme në RGJC për të lindur, për korrigjime, ndërrimi i emrit personal, anulimi i regjistrimit të dyfishtë	5 €
18	Kërkesa për humbje dhe fitim të shtetësisë	10 €
19	Vërtetime dhe dokumente të ndryshme	1 €

2.1 Tarifat tjera të Sektorit të Ofiqarisë

1	Dhënia e çdo lloj certifikate në bazë të dy (2) dëshmitarëve	2 €
2	Certifikata për bashkësinë familjare (shtesa fëmijore)	5 €
3	Legalizimi i fotokopjeve duke krahasuar me origjinalin (1 faqe me tekst)	1 €
4	Vërtetim tjetër për çështje pensioni	5 €

5	Deklarata për ushqimin në vitin kalendarik	5 €
6	Për do kopje të diplomes	1 €
7	Për çdo kopje të certifikatave të legalizueme	1 €
8	Për legalizimin e Aktgjykimeve deri në 2 faqe	1 €
9	Për legalizimin e dokumenteve të Udhëtimit	1.50 €
10	Për Legalizimin e skicave të pronës së palujtëshme	2 €

Nga shërbimi i arkivës:

1	Lëshuarja e një certifikate që lirohet nga pagesa e taksës administrative për një dokument apo vërtetim.	3 €
2	Dhënia në shfrytëzim e projektit nga dokumentet, të cilat gjenden në kuadër të dokumentacionit teknik për një ditë – organizatat humanitare	0 €
3	Dhënia në shfrytëzim e projektit nga dokumentet, të cilat gjenden në kuadër të dokumentacionit teknik për një ditë – persona privat	10 €
4	Për organet shtetërore – private	10 €
5	Certifikata nga librat amë. Evidencat për banor, përgatitja shkollore e të ngjashme	3 €
6	Kërkesa të ndryshme	1 €
7	Ankesa të ndryshme	2.50 €

Nga pagesa e kësaj takse janë të liruar familjet e ngushta të dëshmorëve, invalidët e luftës të gjitha kategorive, veteranet dhe rastet sociale, provë për këtë janë vërtetimet përkatëse.

Neni 13

Ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste biznesore në territorin e Komunës së Glogoc-it

Përgjegjëse: Drejtorati për Zhvillim Ekonomik

Veprimtaria	Tarifa
-2441- Metalurgjia e rëndë-shkritoret	65.000
-0710- Minierat	25.000
-0899- Gurëthyesit	4.000
-5320- Postat, shërbimet postare	900
-6492- Bankat	2.500
-3513- Trafo kryesore-shpërndarës të energjisë elektrike	3.000
-Kompanitë e sigurimeve që merren me sigurimin e automjeteve, pasurisë së personave etj.	500
-4612- Pompat e derivateve në rrugë magjistrale	2.000
-4612- Pompat e derivateve në rrugë regjionale	800
4612- Pompat për derivate në rrugë lokale	200

SHPK të tjera		200
Të gjitha BI me shumicë		200

BI me shumicë do të tarifohen në bazë të raportit të inspektionit.

-7500 - Veprimtaritë shërbyese veterinere.		200
-1411- Prodhimi i veshjeve me lëkurë		
-1520- Prodhimi i këpucëve dhe mbathjeve tjera		
-1610- Prodhimi i zdrëktarisë dhe elementeve tjera(Dyer,dritare etj)		
-1712- Prodhimi i produkteve tjera prej letre,kartuçi.		
-2229- Prodhimi i lendeve plastike		600
-2059- Prodhimi i produkteve tjera kimike		800

13.2. Veprimtarit tjera		
-8622 - Ordinancat Shëndetësore		380
-8623 - Ordinancat Stomatologjike		360
-4773- Barnatoret		250
-5229- Kontrollime teknike		500
-6110- Shpërndarës të internetit dhe -6120- TV kabllorë		250
8423 - Përmbaruesit Privat		700
-8422- Avokaturat		200
-8423- Noteri		500
-0812- Eksploatimi –grumbullimi i rërës për qëllime komerciale		1.000
-8891 - Veprimtaria e Çerdheve		50
-6831 - Agjencitë e ndërmjetësimit në transaksionet e pasurisë së patundshme dhe agjencitë tjera.		400
-1812- Veprimtarit e Shtypshkronjave dhe aktiviteteve grafike		70
-4511- Tregtia e Automjeteve të reja		400
-4519- Tregtia e Automjeteve të vjetra dhe auto-pjesë të vjetra		500

13.3. Njësit e ndërmarrjeve që e ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Komunës paguajnë 30% të tarifës bazë (në rastet që edhe selia është në territorin e Komunës së Drenasit)		
13.4. Bizneset të cilat licencohen nga Ministritë përkatëse,paguajnë taksën Komunale e cila shërben si provë për licencim		
13.5. Tregtia me shumicë e artikujve ushqimor lirohet 30% në zonat rurale të Komunës së Drenasit. -4617-		

1. Çdo biznes në vitin e parë të themelimit/regjistrimit të saj, pa marrë parasysh datën e regjistrimit/themelimit, lirohet nga pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste.
2. Lirohen për kohë të pacaktuar nga pagesa e Taksës Komunale të gjitha Bizneset ekzistuese dhe ato fillestare që ushtrojnë veprimtaritë e tyre në të gjitha sektorët e prodhimtarisë Bujqësore.
3. Të gjitha B. I, NTP, NSH,NH si edhe ato përpunuese si dhe të gjitha llojet e ndërmarrjeve me pakicë janë të liruara nga pagesa e Taksës Komunale deri në kohë të pacaktuar.
4. Të gjitha bizneset që raportojnë në ATK , me pasqyrat financiare (formular) të pagesës së tatimit në qarkullim e të cilët dorëzohen për atë vit kalendarik me zero qarkullim lirohen edhe nga taksa Komunale për atë vit kalendarik që nuk kanë ushtruar veprimtarinë duke i sjellur si dëshmi pasqyrat financiare të vërtetuara nga ATK-ja jo më vonë se 31 prill.
5. Drejtorati për zhvillim Ekonomik shpërndarjen e faturave do të bëjë nga data 1 maj deri më datën 30 qershor.
Të gjitha bizneset në momentin e pranimit të faturës, janë të obliguar që brenda 30 dite të bëjnë pagesën e obligimeve.
Në raste që bizneset nuk marrin faturat, ato janë të obliguara që vetë të interesohen për obligimet e tyre që i kanë ndaj komunës, pra që të vizitojnë zyrën e drejtoratit për zhvillim ekonomik pranë Komunës së Drenasit.

Neni 14

Përgjegjëse: Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Nr. i Tarifës	Shërbimet	Vlera vjetore
------------------	-----------	------------------

dhe ngarkesës		në euro
------------------	--	---------

	Shërbimet	
	Taksat për leje operimi	
	Leje për bllokim të rrugës (shiriti rrugor – trotuarit)	Shuma €
14.1	Zona urbane 12 - orë	20
14.2	Zona urbane 24 - orë	25
14.3	Leje për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në rrugë dhe trotuar, në afërsi të lokaleve afariste, për një ditë	3
14.4	Leje për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në rrugë dhe trotuar, në , në afërsi të lokaleve afariste për 1 muaj	10
14.5	Leje për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në rrugë dhe trotuar, në , në afërsi të lokaleve afariste për 1 vit	50
14.6	Leje operimi për auto taxi 4+1 ulëse, për 1 vit	25
14.7	Leje operimi për kombi-bus 8+1 ulëse (Leje e veçanet për transportin e nxënësve të mësimit fillor, atyre me nevoja të veçanta dhe personave që barten për hemodializ), për 1 vit	25
14.8	Ndërrimi i aktvendimit për leje të operimit për auto-taxi (nënkupthet kur nga pronari ndërrohet automjeti para skadimit të lejes që është pajisur më pare)	15
14.9	Vërtetimi i rendit të udhëtimit për linjën e rregullt të udhëtarëve dhe për transport të veçante, operatori transportues paguan taksën për një vit (për një relacion- nisje të caktuar)	15
14.10	Pëlqim për dhënien lejes për vend-parkimin e automjeteve transportuese për mallra ,zhavor ,dru (Autoparku)/për një vit	150
	Leje për automjetet e renda transportuese me peshë prej (3.5-7.5)ton, të cilat kanë nevojë për qarkullim në ato rrugë(qendrës së qytetit) ku me shenjë të komunikacionit e kanë të ndalur	
14.11	Leje e lëshuar për 1 deri në 3 ditë	5

14.12	Leje e lëshuar për 1 deri në 15 ditë	15
14.13	Leje e lëshuar për 1 muaj	25
14.14	Leje e lëshuar vjetore të cilat rrugë shfrytëzohen here pas here	100

14.15 Parkingjet e rezervuara në hapësirën Publike- parkingje për një vit.

- Zona e pare 100 €
- Zona e dytë 50 €
- Zona e tretë..... 20 €

14.16 Parkingu kohor për një ditë

- Zona e pare 0.90 €
- Zona e dytë 0.40 €
- Zona e tretë 0.20 €

Nga kjo takes lirohen persona më aftësi të kufizuara dhe Shoqatat e luftës

14.17. Taksat dhe ngarkesat për transport TAXI

- Transporti auto-taxi i udhëtareve pa licencë 700 €
- Operatores taxi që ndërprejnë veprimtarin, dhe nuk e kthejnë lejen e operimit 200 €
- Operatores taxi që nuk i kanë automjetet në gjendje sipas kushteve teknike 300 €
- Automjetet që nuk respektojnë rendin e ardhjes dhe vozitjes 200 €
- Autotaxi që nuk e vendosin lejen për ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë të dukshme... 100 €
- Autotaxit që bëjnë bartjen :
 - Fëmijëve nën moshën 6 vjeçare pa praninë e prindit
 - Bartin kafshë të ngordhura
 - Kufoma
 - Material eksplozive(piroteknike) 500 €

14.18 Taksat për dhënien më qira të tregut të gjelbër (sipërfaqja e përgjithshme e tregut)

Zona I..... 1.0 €/m² për vit

Zona II 0.70 €/m² për vit

Zona III..... 0.5 €/m² për vit

Kafshëve

Zona I..... 0.50 €/m² për vit

Zona II 0.30 €/m² për vit

Zona III..... 0.20 €/m² për vit

14.19 Taksat për hyrje në tregun e Gjellbër.

Për kamion 3.5 t 5 € në ditë

Për kamion 5t 7 € në ditë

Për kamion 7.5 t 8 € në ditë

14.20 Taksat për hyrje në tregun e Kafshëve

Hyrja:

Për copë në ditë për kafshë të trasha 2 €

Për kafshë të imta në ditë 0.40 €

14.20.1 Tarifa për matjen e kafshëve në peshoren e tregut të kafshëve:

Për kafshë të trasha 2€ për cope

Për kafshë të imta 0.50 € për cope

14.20.2 Tarifa për shfrytëzim të shtyllave metalike të ndriçimit publik nga kompanitë e telekomit, internetit etj. është 2€ në vit për shtyllë të ndriçimit.

14.20.3 Tarifa për një hyrje/dalje në Stacionin e Autobusëve nga Operatorët për Transport të Udhëtareve është 2€

14.20.4 Tarifa e parkingut për autobus në stacionin e autobusëve jashtë orarit të punës është 2€.

14.20.5. Tarifa për shërbime të mbeturinave të amvisërisë është 4.70 €.

**14.21 PËR HAPËSIRËN NË TË CILËN VENDOSËN REKLAMAT, PANOTË,
KOMPENZIMI PAGUHET ME SA VIJON:**

- Për reklama, pano ndriçuese që tregojnë ku është vendosur lokali

afarist, ngarkesa për një vit është

Zona I 50 € m²

Zona II 30 € m²

Zona III 15 € m²

- Për reklama, pano pa ndriçim dhe lajmërime që tregojnë vendin ku është

vendosur lokali afarist, ngarkesa për një vit është

Zona I 25 € m²

Zona II 15 € m²

Zona III 10 € m²

- Për hapësirën që shfrytëzohet për lojërat e cirkut, lojërave argëtuese etj.

ngarkesa është ditore edhe është 0.50 € m²

- Toka që shfrytëzohet për të vendosur të gjitha llojet e aparateve, (akulllore) për aparat në vit

Zona I 70 €

Zona II 30 €

Zona III 10 €

14.22 Veprimtarit për të cilat kërkohet leje mjedisore komunale (UA MMPH 01/2017)

Të gjitha veprimtarit për të cilat kërkohet Leje mjedisore komunale janë në shtojcën 1 të këtij udhëzimi.

Tarifa për tu pajisur me leje Mjedisore komunale paguhet taksa:

- Në vlerën investive të projektit deri në shumën 25,000 euro paguhet tarifa në vlerë prej:
..... 50 €
- Në vlerën e investive të projektit mbi 25,000 euro paguhet tarifa 0.2% të vlerës investive të projektit.

Të liruar nga pagesa e kësaj tarife janë projektet publike.

Neni 15

Përgjegjëse: Drejtorati për Buxhet dhe Financa

15.1. Ngarkesa për lejen e pronësisë së automjetit ,parkimin dhe tërheqjen e automjetit

Të gjithë banorët dhe bizneset, kërkohet të marrin leje për pronësinë e automjetit Brenda kufijve të Komunës së Drenasit.

Për sigurimin e këtyre lejeve për automjete të bizneseve apo banorëve duhet të sigurohen dëshmi mbi regjistrimin e automjetit nga autoriteti qendror i Kosovës dhe adresën e shtëpisë ose selinë e biznesit të regjistruar pranë MTI-së.

Tarifat për lëshimin e lejes do të paguhet në Komunë në bazë vjetore.

Këto tarifa do të jenë si vijon:

a).Për automjete dhe taksi :

Benzinë – naftë

Deri në 3000 ccm	10 €
Nga 3000 – 3500 ccm	15 €
Mbi 3501	20 €

b).Për Kamion që bëjnë transportin e mallrave:

Benzinë – naftë

Deri në 3.5 t	20 €
Mbi 3.5 t	30 €

c) Për autobus

Për autobusë	30 €
--------------	------

15.2 Nga tarifa për leje për mjete motorike lirohen të gjitha automjetet në pronësi të komunës, KFOR-it, UNMIK-ut, EULEX-it përfaqësive diplomatike, emergjencës (makinat e zjarrfikësve dhe ato të ndihmës së shpejt). Provë për këtë është leja e qarkullimit të automjetit.

Për aplikimin e kësaj pjese (4,5) të tarifave përgjegjëse është Drejtorati për Buxhet dhe financa.

Neni 16

Tarifa e shërbimeve kadastrale komunale të përcaktuara me UA nr. 12/19

Tarifa e rekomanduara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës do të jenë të aplikueshme si me poshtë:

16.1. Tarifat për dhënien e informative nga Sistemi i Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës nga ZKK-të, sipas nenit 21 të UD nr.12/19, janë :

Vërtetimi që personi fizik ose juridik nuk posedon prona.	3 €
Çertifikata e pronësisë -deri në dhjetë faqe shenime të shtypura.	4 €
Çertifikata e pronësisë – mbi dhjetë faqe shenime të shtypura.	20 €
Kopja e Planit.	4 €
Kopja në formatin A3 me ortofoto-bardhë e zi.	4 €
Kopja në formatin A3 me ortofoto-kolor.	5 €
Historiati për një njësi kadastrale.	20 €

16.2. Tarifat për bazën gjeodetike, sipas nenit 22 të UD nr.12/19, janë :

Pikat trigonometrike:	
Pikat trigonometrike – Kordinatat Y,X,H, me përshkrim.	5 €
Pikat lidhëse- Kordinatat Y,X,H, me përshkrim.	4 €
Pika poligonale - Koordinatat Y,X, H me përshkrim.	3 €
Pikë e Nivelimit - Koordinatat Y,X,Z , me përshkrim.	5 €
Pikat në Linjë - Koordinatat Y,X,Z, me përshkrim.	2 €
Pikat e detajit - Koordinatat Y,X.	1 €

16.3. Tarifat për të dhënat në formën digjitale, sipas nenit 23 të Ud nr.12/19 janë:

Parcela në format digjital (shpifile, dwg, gml, ili) deri në 1 ha – sipas kërkesës së pales (pronarit, të autorizuarit, gjeodetit të licencuar apo kompania gjeodete e licencuar, dhjetë euro për njësi.	10 €
Parcela në format digjital (shpifile, dwg, gml, ili) mbi 1 ha deri 2 ha – sipas kërkesës së pales (pronarit, të autorizuarit, gjeodetit të licencuar apo kompania gjeodete e licencuar.	20 €
Parcela në format digjital (shpifile, dwg, gml, ili) mbi 2.01 ha deri 5 ha – sipas kërkesës së pales (pronarit, të autorizuarit, gjeodetit të licencuar apo kompania gjeodete e licencuar.	40 €
Parcela në format digjital (shpifile, dwg, gml, ili) mbi 5 ha – sipas kërkesës së pales (pronarit, të autorizuarit, gjeodetit të licencuar apo kompania gjeodete e licencuar.	60 €
CD – kompakt disku.	0.50 €

16.4. Tarifat e shërbimit për ndërrimin e kulturave të parcelave, sipas nenit 24 të UD nr.12/19, janë:

1.Përgaditja e raportit për ndërrimin e cultures së një parcele pa matje gjeodezike.	10 €
2.Ndërrimi i cultures të një parcele me matje bëhet sipas tarifave të përcaktuara me nenin 25 dhe 26 të UA Nr.12/19.	

16.5. Tarifat e shërbimit për ndarjen e parcelave, sipas nenit 25 të UD nr.12/19, janë :

1.Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe deri në 0.50ha - tetëdhjetë euro për njësi.	80 €
2.Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe mbi 0.50 ha deri 1 ha- nëntëdhjetë euro për një njësi.	90 €
3.Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe mbi 1 ha deri 2.5 ha- njëqind e njëzet euro për një njësi.	120 €
4. Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe mbi 2.50 ha deri 5.0 ha- njëqind e katërdhjetë euro për një njësi.	140 €
5.Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe mbi 5.0 ha deri 10 ha- njëqind e shtatëdhjetë euro për një njësi.	170 €
6.Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës me sipërfaqe mbi 10 ha-treqind euro për një njësi.	300 €
7.Krijimi i një parcele të re nga procesi i ndarjes së parcelës në zona urbane sipas planit urbanistik- njëqind e pesëdhjetë euro për një njësi.	150 €

16.6. Tarifat e shërbimit për bashkimin e parcelave, sipas nenit 26, të UD-12/19, janë:

Krijimi i një parcele të re nga procesi i bashkimit të dy parcelave.	80 €
Për çdo parcelë tjetër në kufi.	35 €
Krijimi i një parcele të re nga procesi i bashkimit të dy parcelave në zona urbane sipas planit urbanistik.	150 €
Për çdo parcelë tjetër në kufi.	70 €

16.7. Tarifat e shërbimit për përcaktimin e kufijëve të parcelave, sipas nenit 27, të UD-12/19, janë:

Për një parcelë me sipërfaqe deri në 0.50 ha – njëqind e tridhjetë euro për një njësi.	130 €
Për një parcelë me sipërfaqe mbi 0.50 ha deri 1 ha – njëqind e tetëdhjetë euro për një njësi.	180 €
Për një parcelë me sipërfaqe mbi 1 ha deri 2.5 ha – dyqind e njëzet euro për një njësi.	220 €
Për një parcelë me sipërfaqe 2.5 ha deri 5 ha– treqind e tridhjetë euro për një njësi.	330 €
Për çdo hektar tjetër.	100 €
Për një parcel urbane sipas planit urbanistik.	300 €

16.8. Tarifat e shërbimit për ri-rregullimin e kufijëvetë parcelave, sipas nenit 28, të UD-12/19, janë:

Për një parcelë me sipërfaqe deri 0.50 ha.	80 €
Për një parcelë me sipërfaqe mbi 0.50 ha deri 1 ha.	100 €

Për çdo hektar tjetër mbi një hektar.	100 €
---------------------------------------	-------

16.9. Tarifat e shërbimit për punët e veçanta gjeodozike, sipas nenit 29, të UD-12/19, janë:

Identifikimi i njësive kadastrale në zyrë.	10 €
Identifikimi i njësive kadastrale në teren.	30 €
Konsulta profesionale dhjetë euro në orë.	10 €

16.10. Lirohen nga pagesa e tarifës për vërtetime dhe certifikata të pronësisë rastet sociale, familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës së UÇK-ës,

16.11. Për t'u liruar nga pagesa nevojitet dëshmia (kartoni) nga qendra për punë sociale, ID ose vendimi për familjet e dëshmorëve dhe të invalidëve të UÇK-ës.

16.12. Lirohen nga të gjitha pagesat zyrtarët komunal, të cilët janë duke vepruar sipas detyrës zyrtare për nevoja zyrtare të komunës.

Transporti për vajtje ardhje nga tereni për gjeodetet bie në barren e organit.

Tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së palujtshme të përcaktuara më udhëzimin e Ministris së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinore nr. 08/2014.

Regjistrimi i pronësisë,shfrytëzimit,në bazë të transaksioneve (shitblerjës)

16.13.Regjistrimi i pronësisë,shfrytëzimit sipas transaksioneve do të bëhet sipas vlerave të transaksioneve të kryera për pronën e palujtshme:

16.14	Për vlerën e transakcionit deri në 10,000 € paguhet taksa prej	20 €
16.15	Për vlerën e transakcionit prej 10,000 € - 30,000 € paguhet taksa prej	30 €
16.16	Për vlerën e transakcionit prej 30,000 € - 50,000 € paguhet taksa prej	35 €
16.17	Për vlerën e transakcionit prej 50,000 € - 100,000 € paguhet taksa prej	50 €
16.18	Mbi 100,000 €,për çdo 50,000 € tejkalim, paguhet vlere prej 30 € por shuma nuk duhet te kaloj 300 €	

16.19. Po që së vlere e kontratës – transakcionit është e pa vlerësueshme paguhet taksa në vlerë prej: **70 €**

16.20. Regjistrimi i pronësisë,shfrytëzimit në bazë të dokumentit mbi dhuratën.

Nëse në dokumentacion (kontratë) mbi dhurimin e pronës e që dhuratëdhënësi është anëtarë i familjes apo pasardhës i dhuratëdhënësit është e caktuar vlere e pronës në këtë rast do të paguan **30%** taksa tarifa për çdo pronar –posedues që fiton të drejtën mbi pronën e palujtshme sipas dhurimit,sipas tarifës të përcaktuar me nenin 2 të këtij udhëzimi administrative.

Nëse në dokument (kontratë mbi dhurimin janë antarë të familjes por prona është e pavlersuar do të paguhet taksa në Shumen prej..... 50 €

Nëse në dokumentin (kontratën) mbi dhurimin dhuratëmarrësi nuk është antarë I familjes dhe nuk është e caktuar vlera e pronës në këto raste do të paguhet taksa-tarifa në shumen prej..... 80 €

Regjistrimi i pronësisë,posedimi në bazë të dokumentit të organit administrative dhe gjyqësor mbi njohjen e të drejtës pronësisë-posedimit.

Regjistrimi i të drejtave mbi pronën e palujtshme e cila fitohet në bazë të vendimit të organit administrative apo gjyqësor bëhet duke paguar taksat-tarifën në shumen prej 50 €

16.21. Regjistrimi i pronësisë,posedimit në bazë të pjesëtimit (ndarjes) të pronës në bashkëpronësi dhe pronësi të përbashkët.

Regjistrimi i pronësisë,posedimi në bazë të pjesëtimit (ndarjes) fizike të pronës nga bashkëpronësia ,pagesa bëhet duke paguar nga se cili bashkëpronar shumën prej : 20 €

Për regjistrimin e pronës së përbashkët të bashkëshortëve bëhet duke paguar tarifen në shumen për akt juridik në vlerë prej 20 €

Regjistrimi i pronësisë së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi me të gjithë pronarët e pjesëve të veçanta bëhet duke paguar tarifen në shumen prej..... 100€

16.22. Regjistrimi i pronësisë,posedimit,në bazë të Trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare.

Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të trashëgimisë bëhet për çdo trashëgimtar në shumë prej 10 €

Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare bëhet duke paguar tarifen për çdo anëtarë të familjes që bëhet pronar,posedues në shumën prej10 €

16.23.Regjistrimi i pronësisë,posedimit,në bazë të ndrrimit të pronës së palujtshme

Regjistrimi i pronësisë, posedimi, në bazë të ndrrimit të pronës së palujtshme, bëhet për secilin pronarë-posedues duke paguar tarifen në Shumën prej.....30 €

16.24.Regjistrimi i Hipotekave

Regjistrimi i hipotekave do të bëhet sipas vlerave të kërkesave (kredive) të përcaktuar me dokumentin e hipotekës dhe atë:

Kërkesa (kredia) në vlerën deri 10.000€ paguhet taksa-tarifa në shumen prej 10€

Kërkesa (kredia) në vlerën prej: 10.000€ e deri në 30.000€ paguhet taksa-tarifa në shumen prej.. 20€

Kërkesa (kredia) në vlerën prej: 30.000€ e deri në 50.000€ paguhet taksa-tarifa në shumen prej... 30€

Kërkesa (kredia) në vlerën prej: 30.000€ e deri në 50.000€ paguhet taksa-tarifa në shumen prej 30€

Kërkesa (kredia) në vlerën prej: 50.000€ e deri në 100.000€ paguhet taksa-tarifa në shumen prej 80€

Mbi vlerën e 100.000€, për çdo 100.000€ e tejkalim paguhet edhe nga 30€ por shuma e tarifës muk mund t'a kaloj vlerën e 400€.

Ndryshimi dhe fshirja e hipotekës

16.25.Ndryshimi i hipotekës së regjistruar bëhet duke paguar në shumen prej: 30€

Për fshirjen e Hipotekës nga regjistri i të Drejtave mbi pronën e Palujtshme duhet të paguhet taksa –tarifa në shumen prej:..... 10€

16.26.Regjistrimi i Servituteve

Regjistrimi i të drejtës së servitutit në Regjistrin e të Drejtave mbi pronën e palujtshme bëhet duke paguar tarifen në shumen prej:50€

Fshirja e servitutit nga regjistri bëhet duke paguar tarifen në shumen prej:.....20€

16.27.Regjistrimi i të drejtës së shfrytzimit-qirambajtje

E drejta e shfrytzimit-Qirambajtje me kohëzgjatje prej 3 deri 10 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumën prej:.....50€

E drejta e shfrytzimit-Qirambajtje me kohëzgjatje prej 10 deri 25 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumën prej:.....150€

E drejta e shfrytzimit-Qirambajtje me kohëzgjatje deri 99 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifën në shumën prej:.....500€

16.28.Për ndryshimin dhe fshirjen e të drejtës së shfrytzimit-qirambajtje bëhet duke paguar 20% e shumës që është paguar për regjistrim e të drejtës së shfrytzimit.

Me rastin e bartjes të të drejtës së shfrytzimit-qirambajtjes ose nënqirasë tek personat e tretë paguhet tarifa e cila është përcaktuar në nenin 2 dhe 3 të këtij udhëzimi administrative.

